

Njoftim për Shtyp datë 11 Mars 2025

Datë: 11.03.2025



KLGJ
KËSHILLI I LARTË
GJYQËSOR

Sot, më datë 11.03.2025, Këshilli i Lartë Gjyqësor zhvilloi Mbledhjen Plenare të radhës, në të cilën shqyrtoi çështjet si më poshtë:

Këshilli vendosi për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për:

- 1 (një) pozicion të lirë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës;
- 1 (një) pozicion të lirë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Gjithashtu, Këshilli miratoi vendimin për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 75, datë 20.02.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në përmbushje të detyrimeve ligjore, Këshilli vendosi miratimin e raporteve për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtareve znj. {...}, znj.{...}, znj.{...}, znj.{...} për vitin 2022, si dhe raportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares znj. {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016.

Këshilli vendosi të shtyjë shqyrtimin e projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares znj. {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”.

Për shkak të rëndësisë së çështjeve, Këshilli vendosi të shtojë për shqyrtim projektvendimet:

“Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit z. Shkëlzen Liçaj në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës”.

“Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit z. Taulant Banushi në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”.

“Për transferimin e gjyqtares znj. Ejona Lazellari në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”.

Në vijim, Këshilli miratoi vendimet për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit Shkëlzen Liçaj në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës si dhe të gjyqtarit Taulant Banushi në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Në përfundim, Këshilli miratoi vendimin për transferimin e gjyqtares znj. Ejona Lazellari në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.